



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 16, datë 28. 03. 2023

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE FAMILJES SË KADRI MUÇI,  
PËR DËMET NDËRTIMORE NË BANESË,  
TË SHKAKTUARA NGA ZJARRI I DATËS 07. 03. 2023”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28. 03. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeversijen Vendore” i ndryshuar, në Ligjin Nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, VKM- në Nr. 329, date 16. 05. 2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe në vendimin e Këshilli Bashkiak Skrapar Nr. 86, datë 21. 12. 2022, “Për miratimin e projekt buxhetit afatmesëm 2023- 2025 dhe buxhetit vjetor 2023, të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”, si dhe në relacionin e përgatitur nga administrata e bashkisë

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare familjes së Z. Kadri Muçi në vlerën 1 572 059 (një milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëdhjetë e nëtë) lek, për dëmet ndërtimore në banesë, me numër pasurie 79/3, Zona Kadastrale 1216, fshati Blezënkë, Njësia Administrative Çepan, të shkaktuara nga zjarri i datës 07. 03. 2023.
2. Efektet financiare do të përballohen nga Fondi i Emergjencave Civile, parashikuar në Buxhetin e Vitit 2023, të Bashkisë Skrapar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore.

Vendimi u miratua me 11 vota Pro, Kundër – s’ka, Apstenim – s’ka  
Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

